

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Janar 2025

SHQIPËRIA PRANON CERTIFIKATAT E QARKULLIMIT EUR 1



Nga data 1 janar 2025, Shqipëria pranon Certifikatat e Qarkullimit EUR-1 të lëshuara në mënyrë elektronike nga vendet pjesëmarrëse në Konventën pan-Euro-Mediterrane.

Ky njoftim i referohet: *Ligjit 59/2024 datë 6 qershor 2024 (Fletore Zyrtare nr.113 datë 4 korrik 2024)* "Për miratimin e vendimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës për ndryshimin e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-Euro-Mediterrane të Origjinës dhe të Rekomandimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-Euro-Mediterrane të Origjinës" si dhe: Vendimit 1/2024 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale, Vendi i cili lëshon certifikata të qarkullimit EUR.1 në mënyrë elektronike dhe data se kur ka filluar lëshimi i tyre, tregohet në njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria C.

16,4 MILIARDË LEKË TË ARDHURA NË MUAJIN JANAR



Administrata Doganore e mbylli muajin Janar 2025 duke realizuar 16,4 miliardë lekë të ardhura, ose 100,5% të planit. Krahasuar me muajin Janar 2024, janë realizuar 1,3 miliardë lekë, ose 13 mln € më shumë.

Edhe mallrat e akcizës kanë patur një performancë fantastike në muajin Janar 2025, ku veçojmë Karburantin me **+8,100 ton** më shumë se Janari i vitit 2024, Birrë **+1,300 ton**, Kafe **+130 ton** dhe cigare **+11 ton**.

4 SHËRBIME TË REJA DOGANORE ONLINE PËR BIZNESIN

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me AKSHI-n ka realizuar me sukses testimet për 4 shërbime të reja doganore të cilat ofrohen online nëpërmjet platformës E-Albania. *Shërbimet e reja që do të ofrohen online janë:*

1. Kërkesë për shtesa/ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Përpunimit Pasiv

Regjimi i përpunimit pasiv lejon që mallrat shqiptare të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që t'u nënshtrohen operacioneve përpunuese dhe produktet që dalin si rezultat i këtyre operacioneve të vendosen në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit.



2. Aplikim për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale

Shërbimi "Aplikim për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale" përdoret në ato raste kur operatorët ekonomikë për arsye të ndryshme të argumentuara dhe të dokumentuara kërkojnë kryerjen e formaliteteve doganore në degët doganore të ndryshme nga dega doganore kompetente për territorin ku është vendosur aktiviteti (çdo vit apo periudha të vitit).




3. Kërkesë për shtesa/ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Magazinës Doganore

Magazinimi i Përkohshëm është statusi i mallrave joshqiptare nga momenti që ato paraqiten në doganë deri në caktimin e një destinacioni doganor.



4. Kërkesë për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një mbajtës tek një tjetër të Autorizimit për RPA

Sipas kërkesave të ndryshme që mund ti paraqiten një Operatori Ekonomik gjatë procesit të punës mund t'i lind nevoja e transferimit të mallrave nën RPA nga një mbajtës i Autorizimit të RPA në një mbajtës tjetër të Autorizimit të RPA.



PROJEKTE TË REJA DREJT DIGJITALIZIMIT TË PROCEDURAVE DOGANORE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me **AKSHI-n** dhe **UNCTAD** ka zhvilluar disa projekte që synojnë digjitalizimin e procedurave doganore në funksion të rritjes së transparencës, rritjes së efektivitetit, uljes së kostos dhe kohës së biznesit.

1- Ndërveprimi me ASYHUB, për marrjen e informacionit para mbërritjes së kontenerëve me qëllim përshpejtimin e analizës së riskut dhe procedurave doganore për mallrat që vijnë në Portin e Durrësit.

2- Ndërveprimi i sistemit të doganave ASYCUDA World me E-DPSHTRR, me qëllim parandalimin e trafikimit të mjeteve rrugore dhe falsifikimin e dokumentacionit të tyre dhe parandalimin e trafikeve të paligjshme.

3- Ndërveprimi me AKU, projekt që synon ndërveprimin e sistemit ASYCUDA World me sistemin AKU-Net duke mundësuar që dokumentet e lëshuara nga AKU të integrohen në mënyrë elektronike në sistemin e doganave.

4- Shkarkimi i manifestit nga dokumenti T1, që synon të lehtësojë mbikëqyrjen doganore të mallrave nën statusin e magazinimit të përkohshëm, duke realizuar shkarkimin në mënyrë automatike të manifestit për mallrat që lënë këtë status, duke u vendosur në regjimin e tranzitit.



5- Aplikimi i QR code, i cili do të mundësojë shtimin e elementeve të sigurisë të deklarës doganore, si dokumenti i vetëm administrativ në mënyrë operative nëpërmjet përdorimit të smartphone, si dhe rritjen e garancisë së shkëmbimit të të dhënave të Administratës Doganore me organizma publike, ose private.

6- Moduli i deklarimit të thjeshtuar, projekt që do të realizojë përdorimin e deklarës së thjeshtëzuar për dërgesat që vijnë përmes postave të shpejta dhe synon uljen e kohës së përpunimit të dërgesave postare, si dhe një transparencë lidhur me pagesën e detyrimeve doganore.

FORUMI I BIZNESIT MES DOGANAVE DHE DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave së bashku me Dhomën Amerikane të Tregtisë zhvilluan takimin Biznes-Dogana, traditë e përvitshme e një forumi të hapur diskutimesh që synon të zhvillojë dialogun mes biznesit dhe Administratës Doganore Shqiptare.



Drejtoria e Përgjithshme e Doganave prezantoi gjatë këtij takimi risitë në proceset digjitale që lehtësojnë dhe përshejtojnë procedurat doganore, nga çdoganimi i mallrave të importit, deri në kontrollin e produkteve ushqimore, si dhe projekte të reja në ndihmë të biznesit.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Z. Genti Gazheli, në fjalën e tij, u shpreh se, Administrata Doganore, me kurajon profesionale dhe vizionin e një administrate eficente ofron sot risitë më të fundit në proceset digjitale që lehtësojnë dhe përshejtojnë procedurat doganore, nga zhdoganimi i mallrave të importit, deri në kontrollin e produkteve ushqimore, si dhe projekte të reja në ndihmë të biznesit. *"Për vitin 2025 si Administratë Doganore jemi të fokusuar në tre pika kryesore: Eficensë, Siguri dhe Prosperitet për të përmirësuar të gjitha shërbimet doganore,"* deklaroi ai.

DOGANA DIGJITALE



Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Janar 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **498 shërbime online**.

➔ KONFERENCË PËR INTEGRIMIN EKONOMIK RAJONAL NË MAL TË ZI



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli ishte i pranishëm në Konferencën e Nivelit të Lartë për Integrimin Ekonomik Rajonal, **"EMPOWER, INTEGRATE, GROW"**, organizuar nga GIZ, e cila u mbajt në Mal të Zi. Konferenca mbledhi së bashku Drejtorët e Doganave të rajonit, zyrtarë të Bashkimit Europian, politikëbërës, udhëheqës biznesi dhe ekspertë për të diskutuar mbi arritjet në tregtinë rajonale si dhe për të eksploruar hapat e ardhshëm drejt integritit të mëtejshëm me tregun e vetëm të BE-së.

Drejtori i Doganave Shqiptare, gjatë fjalës së mbajtur në këtë Konferencë, u shpreh se Administrata Doganore Shqiptare është e angazhuar plotësisht në procesin e integritit në fushën e doganave, me qëllim arritjen e standarteve të unionit doganor europian. Nga ana tjetër ai veçoi se, rritja e të ardhurave nga Doganat Shqiptare ka qenë e qëndrueshme vitet e fundit, duke arritur një tjetër rekord për vitin 2024, me rreth **2.3 miliardë euro të ardhura** që përkthehen në më shumë fonde për buxhetin e shtetit, për arsimin, shëndetësinë, mbrojtjen sociale etj..

➔ DITA NDËRKOMBËTARE E DOGANAVE

26 Janari shënoi Ditën Ndërkombëtare të Doganave, një përvjetor për zyrtarët që punojnë çdo ditë për të garantuar efikasitetin e tregtisë globale, sigurinë në kufijtë kombëtarë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Këtë vit, fokus i veçantë po i kushtohet nevojës për t'i kthyer angazhimet në veprime të prekshme që avancojnë lehtësimin e tregtisë, garantojnë sigurinë dhe nxisin rritjen e qëndrueshme ekonomike, si pjesë e tematikës së OBD-së për vitin 2025: "Doganat në përmbushjen e angazhimit për efikasitet, siguri dhe prosperitet", një slogan që fton administratat doganore të forcojnë rolin e tyre si një motor inovacioni dhe një shtyllë e tregtisë globale, duke krijuar një ekuilibër midis aktiviteteve të lehtësimit dhe kontrollit të tregtisë, që lejon procedura të shpejta dhe efikase të zhdoganimit, si dhe lufton trafiket e paligjshme.

